

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-239/11

Prishtinë, 8 maj 2012

Në procedurën ligjore

Z.P.

Paraqitësi i kërkesës/Ankuesi

kundër

K.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, antarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPKK/D/A/111/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00256), të datë 13 maj 2010, pas shqyrtimit të mbajtur më ... maj 2012 dhe në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 12.2 po aty në lidhje me nenin 465.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, mori këtë:

AKTGJYKIM

1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e Z.P. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/111/2011, lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00256.

2- Konfirmohet vendimi KPCC/D/A/111/2011 që i referohet lëndës që është e regjistruar në AKP me numrin KPA00256.

3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 155 (njëqind e njëzetepesë euro) brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 15 janar 2007, Z.P. (paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkonte ri-posedimin e objektit afarist, dyqanit nr. 28, që përbëhej prej 2 kateve (dhe dy dhomave), me sipërfaqe prej 44 metra katror në rrugën Skenderbeu në Glllogovc. Sipas kërkesës, palujtshmërija i ishte ndarë paraqitësit të kërkesës si “tokë ndërtimore”. “Ndërtimi i objektit ishte lejuar në bazë të shpalljes, sipas projektit dhe pranimin nga komisioni teknik. Objekti funksiononte në bazë të lejes nga autoriteti komentet nga viti 1997 deri me 2001, kur autoritetet komunale kishin konsideruar se ajo ishte lëshuar nga okupatori”.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP planin e përgjithshëm të vitit 1980 dhe planin detal urbanistik të vitit 1982; skicën 07/353-466 të datës 21 janar 1997; projektin e përgjithshëm të objektit të ndërtuar nr. 28 në ngastrën nr. 763; vendimin 07/352-466 të datës 21 janar 1997; vendimin 02/351-152, të datës 02 qershor 1997; vendimin mbi pranimin teknik dhe lejen e shfrytëzimit 07/351-280 të datës 09 tetor 1997; procesverbalin nr. 17/1, të datës 15 gusht 1999; vendimin 17/1, të datës 14 shtator 1999; njoftimin nr. 361-12, të datës 29 shtator 1999; vendimin C.nr.50/01, të datës 07 maj 2001; vendimin ekzekutiv nr. 2001/6; njoftimin nga zyra e avokatit publik nr. 27/2002, të datës 05 qershor 2002; vendimin 353-129, të datës 08 mars 2002; vendimin A nr. 19/2001, të datës 27 shkurt 2001, të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës; vendimin nr. 50/2001, të datës 24 gusht 2001; përgjigjen nga Qeveria e Kosovës nr. 139-06, të datës 25 janar 2005; njoftimin e datës 02 shkurt 2005; regjistrin e përkohshëm nr. 1599/2005, të datës 01 mars 2005; aktgjykimin nr. 444/2001, të datës 21 mars 2005; përgjigjen nga Thomas J Monaghan, Drejtor i Departamentit të Drejtësisë; informatën e JIU/06/ag/115, të datës 24 shkurt 2006; përgjigjen nr. 412, të datës 11 korrik 2006; raportin e datës 30 qershor 2006.

Paraqitësi i kërkesës e ka cilësuar K. si uzurpues të pronës.

Me datë 31 mars 2008 AKP-ja ka vazhduar me njoftimin e lëndës duke vendosur një afishe në vendin ku ndodhej shitorja. Në raportin e saj, të datës 31 mars 2008, AKP-ja ka cekur se prona është një

dyqan i shkatërruar; i uzurpuar nga K., e cila pretendon të drejtën ligjore ndaj tij përmes përfaqësuesit të saj.

Me vendimin grupor Nr. KPKK/D/C/11/2011, të datës 13 maj 2011, lidhur me kërkesën 00256, KKPK-ja ka vendosur se kërkesa bie jashtë mandatit të Komisioni të përcaktuar në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079. Komisioni ka vërejtur se paraqitësi i kërkesës tashmë e kishte kundërshtuar vendimin e Kuvendit Komunal në gjykatat vendore, të cilat janë organe kompetente i duhur për zgjidhjen e kontesteve pronësore që nuk kanë të bëjnë me konfliktin e viteve 1998-1999. Pas vendimit përcjellës. Komisioni ka nxjerrë një vendim individual me datën 22 gusht 2011 për hedhjen poshtë të kërkesës.

Paraqitësi i kërkesës e ka pranuar vendimin e KKPK-së me 21 shtator 2011.

Me 28 shtator 2011, paraqitësi i kërkesës, tani pala ankuese ka paraqitur një ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të lartpërmendur.

Pala ankuese e atakon në tërësi vendimin duke pretenduar se i njejti është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitës së procedurës kontestimore; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ai po ashtu potencon se vendimin ka qenë i ndikuar nga politika.

Ai ka sqaruar se në vitin 1992, K. kishte bërë shpallur një njoftim për ndarjen e trojeve në rrugën Skenderbeu në Drenas (Glllogovc) dhe 95 kishin aplikuar. Trojet iu ishin ndarë 45 prej tyre. Edhe vetë paraqitësi i kërkesës kishte aplikuar dhe ai i ishte ndarë trualli në vitin 1997. Si rezultat i kësaj ishte ndërtuar objekti i tij afarist dykatësh. Objekti afarist ishte ndërtuar sipas planit urbanistik. Atij i ishin lëshuar lejet e vlefshme, duke përfshirë edhe lejen ndërtimore, pranimin teknik dhe lejen e punës. Megjithatë, më 29 shtator 1999, qeveria e përkohshme e K. kishte urdhëruar lirim të objekteve. Me 28 mars 2001, ata kishin pranuar një urdhëresë nga K. për largimin e objekteve nga publiku. Më 26 prill 2001, të gjithë tregtarët kishin paraqitur kërkesë në gjykatën komunale kundër K. për pengim të posedimit. Gjykata kishte caktuar masën e përkohshme, duke aprovuar në këtë mënyrë kërkesën e tregtarëve të Drenasit. Pastaj kanë pasuar procedura të ndryshme dhe përfundimisht Gjykata Supreme mori vendim me datën 21 mars 2005 duke shfuqizuar të gjitha vendimet e marra nga qeveria komunale dhe ajo qendrore. Pasi që vendimi nuk ishte zbatuar, paraqitësi i kërkesës kishte shpresuar se AKP-ja do të merrte ndonjë masë, por ajo nuk e bëri këtë. Përfundimisht objekti në fjalë ishte larguar.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase lënda nuk i përket juridiksionit të KKPK-ës.

Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Vetë paraqitësi i kërkesës përshkruan se objekti i kontestuar (së bashku me objektet e ngjashme në të njëjtën rrugë) ishte ngritur pasi që ati i ishte ndarë trualli nga komuna përkatëse dhe më vonë komuna kishte vendosur që të revokojë ndarjen e parcelës, respektivisht që të largojë objektin dykatësh (shiko urdhëresën e datës 28 mars 2001) dhe të ndërtojë objektet në sheshin e qytetit në të njëjtën tokë sipas planit të ri urbanistik. Si rezultat i kësaj, objektet, duke përfshirë dhe këtë që është subjekti i çështjes aktuale, janë larguar/demoluar diku pas 28 marsit 2001, dmth. paraqitësi i kërkesës e kishte humbur posedimin pas 28 marsit 2001 apo siç e ka pranuar KKPK-ja në vitin 2005, e që në cilindo rast kjo është shumë kohë pas knfliktit të armatosur të viteve 1998/1999. Ligjshmëria e këtij largimi/demolimi ka qenë subjekti i kontestit civil në gjykatat e rregullta civile të Kosovës, ashtu siç e sqaron edhe vetë paraqitësi i kërkesës dhe ashtu siç vërtetohet nga dokumentet e shumta që lidhën me lëndën. Prandaj, largimi/demolimi i objektit afarist nuk ka qenë i ndërlidhur ose nuk ka rezultuar nga konflikti i armatosur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Prandaj, humbja e posedimit nuk ka qenë e ndërlidhur me këtë dhe nuk ka rezultuar nga kjo.

Se a ka qenë ligjor dhe i drejtë vendimi i komunës për të revokuar ndarjen e parcelave dhe më vonë largimin e objekteve për të ndërtuar sheshin, kjo nuk mund të jetë objekt i procedurës para AKP-së, respektivisht para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme. Kjo është jashtë juridiksionit të KKPK-së, respektivisht Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme.

Pasi që kërkesa është jashtë juridiksionit të KKPK-së, KKPK-ja nuk ka për detyrë që të vendos rreth pronësisë së paraqitësit të ankesës.

Duke ndjekur të njëjtën linjë – për shkak të mungesës së juridiksionit, Gjykata nuk ka për detyrë që të vendos nëse ankuesi është ose jo pronar i pronës së kërkuar.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Aneksit III, nenit 8.4 të UA 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, zbatohet regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës së kërkuar më arsye mund të vlerësohet deri më € 15.000: €125 (€50 + 0,5% e € 15.000).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi i dorëzohet atij.

Këshillë juridike:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it